**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr 52 date27/04/2001

# MBI KRIJIMIN E KOMISIONIT TE KESHILLIT BASHKIAK PER KONTROLLIN E BRENDSHEM FINANCIAR TE BASHKISE

Në mbështetje të nenin 21 të ligjit nr.8652, dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", Këshilli Bashkiak i qytetit të Tiranës, pasi u njoh me relacionin "Mbi krijimin e komisionit të Këshillit Bashkiak për kontrollin e brendshëm financiar të Bashkisë" e paraqitur nga Kryesia e Këshillit

**V E N D O S I**

1. Krijimin e komisionit të Këshillit Bashkiak per kontrollin e Brendshëm financiar të përdorimit të shpenzimeve që miraton Këshilli në interes të Bashkisë

2. Komisioni të përbëhet prej 3 anëtarësh:
   -Genci Ramaj, ekonomist, këshilltar
   -Shefikat Ngjela, ekonomiste, këshilltar
   -Pjetër Dema, ekonomist, këshilltar
   Njëri prej të cilëve zgjidhet me cilësinë e kryetarit të komisionit

3. Organi ekzekutiv duhet të vejë në dispozicion të komisionit, dokumentacionin kontabël dhe financiar të kërkuar dhe përgjigjet para tyre sa herë që ata e gjykojnë të arsyeshme

4. Mandati i ushtrimit të kësaj detyre është deri në konstituimin e Këshillit të ri Bashkiak

5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të rregullores se funksionimit të komisionit nga Këshilli Bashkiak

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**